



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 06.11.2018, ora 15:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Prezantimi dhe shqyrtimi në parim i projektligjeve financiare që kanë lidhje me buxhetin.

(Komision për dhënie mendimi)

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Eglantina Gjermeni, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Robert Bitri, Dritan Bici, Edmond Leka, Fadil Nasufi dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Florjon Mima, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Lorenc Luka, Hekuran Hoxhalli, Lefter Koka, Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Erion Luçi – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Nikolla Lera – Drejtor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Eduard Shalsi – Mirëdita sërish, të nderuar deputetë!

Atëherë kalojmë në pikën e dytë për ditën e sotme, në diskutimet e projektligjeve financiare që kanë lidhje me buxhetin e vitit 2019.

Relator është zoti Ilir Beqaj. Ky buxhet do të shqyrtohet në parim në seancë parlamentare të datës 22 nëntor 2018 dhe pastaj, respektivisht, me datën 3 dhjetor do të miratohet nen për nen.

Ne jemi komision për dhënie mendimi.

Sot kemi ftuar ekipin e Ministrisë së Financave, kryesuar nga zëvendësministri, zoti Erjon Luçi, të cilit i uroj mirëseardhjen bashkë me z. Nikolin Lera.

Urdhëroni për procedurë!

(Mungesë regjistrimi)

Besnik Baraj – ...ndotjen apo mekanizma financiarë. A është e mundur që ne të dalim me propozimin që 10% të taksave që paguhen për këtë qëllim, pra për ambalazhe të tjera, gjithashtu të përdoren për t’ju kthyer atyre që grumbullojnë ambalazhin? Pra, në qoftë se ne paguajmë taksë, kemi 100 lekë. Për shembull, tani nuk është 100 lekë, por është 35 lekë e zëmë, pra ai paguan 35 lekë për kilogram dhe 3,5 lekë për kilogram në t’ju rimbursojmë atyre që grumbullojnë plastikën. Në këtë mënyrë ne vendosim një mekanizëm ekonomik për të nxitur grumbulluesit, që shpeshherë nuk kanë interes ekonomik, dhe për buxhetin e shtetit kjo është fare e papërfillshme. Pra, bëhet fjalë për 3 mijë tonë plastikë në Shqipëri, që grumbullohet, dhe jam i bindur që kjo do të formalizojë grumbullimin, sepse shpeshherë nuk raportohet. Nga ana tjetër, ai vetëm duke e formalizuar do të marrë këtë 3,5 lekë për kilogram dhe, njëkohësisht, nxit grumbulluesit që ta shtojnë këtë sasi. E dini sa është sasia? Është qesharake. Bëhet fjalë për 300 milionë pjesëtim për 3, pra bëhet fjalë për 100 milionë lekë të vjetër për buxhetin e shtetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Urdhëroni, zoti Beqaj!

Ilir Beqaj – Ligjet, përveçse specifikës kanë gjithsecili, duhen vlerësuar edhe në kompleks. Në fund të fundit, këtu kuptohet se qëllimi është, nga njëra anë, të kemi një mjedis fiskal për të bërë biznes, por edhe të kemi financa publike të shëndetshme, sepse nga mosshëndeti i tyre vuajë ekonomia, biznesi dhe familjet shqiptare.

Kam përshtypjen se ndryshim pas ndryshimi ne kemi bërë ndërhyrje, të cilat krijojnë ende hapësirë për arbitrazh fiskal. Në mendimin tim personal, i gjithë projektligji “Për procedurat tatimore të Republikës së Shqipërisë”, po t’i shikojmë të gjitha këto ndryshime, janë më shumë është si rregullore inspektimi se sa ligj. Sigurisht, procedurat

tatimore janë kod, por të gjitha këto janë bërë sepse ne kemi krijuar lehtësira në mënyrë jo koherente, të cilat kanë sjellë këto që bëjmë sot. Ndiqeni pak çfarë bëjmë këtu sot. Në Shqipëri nuk mund të ketë më një individ, që mund të ketë dy NIPT-e, pra personi fizik, duke filluar nga data 1 janar 2019.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk mund të jetë më asnjë individ që të ketë dy NIPT-e të personave fizikë të ndryshëm. Pse arritëm këtu?! Thamë vetë se deri kaq lekë tatohet me 5%, pastaj edhe kjo tjetra me 5% dhe, sigurisht, njerëzit duke mos bërë evazion, por duke kuptuar se çfarë të lejon vetë legjislacioni fiskal bënë sjelljen e tyre. Për pak humor, çfarë ju tha Trampi kundërshtarëve: “Ai ishte ligji, unë isha i zoti dhe pagova shumë më pak se sa paguanin të tjerët, pra nuk kam bërë shkelje ligji”. Këtë kemi bërë gjithë këto vite dhe druham se përsëri po vazhdojmë në këtë drejtim.

Shqetësimi i dytë është ky: këtu kemi 7 ligje, apo jo? Në korrik kishim 4 ligje, pra kemi bërë 11 ndryshime ligjore brenda vitit, ndërkohë biznesi kërkon stabilitet dhe kërkon parashikueshmëri. Këtë debat e kemi bërë. Pse i bëmë ndryshimet e korrikut kur do të hynin në fuqi të gjitha bashkë më 1 janar? Biznesi, edhe pse këtu mund të ketë grupe që e shikojnë me interes, thotë: prit se çdo 6 muaj na bëjnë ndonjë të papritur dhe krijohet një lloj klime ose e ngremë, ose e ulim.

Mbaj mend kur ishim në opozitë, unë kam qenë partizani kryesor se në 8 vjet Saliu të gjitha ligjet i ndryshoi 77 herë. Edhe unë çdo dy javë këtë muhabet bëja. Prandaj them se ndryshimet e korrikut ishin të pakuptimta, sepse të dyja bashkë më 1 janar do të hynin në fuqi. Madje, ato ishin edhe më të favorshme dhe njerëzit i harruan dhe nuk na i dimë më as për nder, pra duket sikur ka qenë një gjë e kaluar.

Te ligji “Për procedurat tatimore”, për shembull, në qoftë se unë jam individ dhe kam dy NIPT-e të personit fizik, a nuk më lejohen më të reja apo duhet t’i mbylлим, a ka ndonjë dispozitë transitorë?

Nikolla Lera – Kemi vendosur një klauzolë, ku administrata tatimore ka të drejtë, pra ne i kemi mbuluar të dyja situatat. Pra, me hyrjen në fuqi të këtij ligji një individ të mos lejohet të regjistrojë 1, 2, 3, 5 apo 10 NIPT-e, por i kemi dhënë zgjidhje situatës. Një individ, kur hyn ligji në fuqi është i regjistruar me 5 NIPT-e, por administrata tatimore për efekt të llogaritjes së detyrimit fiskal të këtij individi, ka të drejtën ligjore që t’ia konsiderojë të ardhur dhe shpenzim si të integruar në një të vetëm dhe ta taksojë me atë normë që i takon për t’u taksuar.

Ilir Beqaj – Atëherë, administrata ka të drejtën apo detyrimin për ta bërë kështu? Sepse po që e drejtë inspektori e merr fakultative dikujt ia bën, dikujt nuk ia bën. Duhet ta shikojmë formulimin.

Nikolla Lera – Do ta gjej formulimin dhe do ta them.

Ilir Beqaj - Në nenin 11 të kësaj me të drejtë keni futur rrugën elektronike, por mos duhet të fusim ndonjë komunikim elektronik të besuar, sepse duhet folur edhe me përfaqësuesit të Komisionit të Ligjeve. Nuk mjafton të themi këtu që po ta solla me *email* kjo është provë, siç është posta rekomande, sepse ende një *email* i pacertifikuar nuk ka peshë juridike në Shqipëri.

Nikolla Lera – Ne patëm debate të mëdha me administratën tatimore, sepse administrata tatimore nuk bën punën, por merret vetëm me nisje shkresash nisje letrash. Domethënë, është një volum i çmendur letrash dhe shkresash, që nisen në drejtim të tatimpaguesve dhe nuk bën funksionet e saj, por merret me këtë.

Ilir Beqaj - Niko, e di pse janë shumë letra, sepse bëjmë ne kështu gjërash...

Nikolla Lera – Misioni i FMN-së në 3-4 raportet e fundit ka thënë: “hiqni dorë nga letrat dhe fusni komunikimin elektronik”. Ata bënë kërkesa që të futej komunikimi elektronik” për çdo komunikim me tatimpaguesin, por ne vendosëm që t’ia lejojmë rrugën elektronike vetëm për ato komunikime, të cilat nuk prekin pjesët e anikimimeve e të tjera. Për shembull, nuk lejojmë komunikimin elektronik për një njoftim dhe vlerësim, i cili është një dokument që kërkohet në gjykime e të tjera. Por për dokumente që janë paralajmërues, për shembull, për vendimin e fundit, para se të merren masa shtrënguese, paralajmërimet e të tjera pra për elemente që nuk do të na krijojnë ato probleme që përmendët ju.

Ilir Beqaj - Në rregull.

Tani vijmë te diskutimi më i qenësishëm nga pikëpamja financiare, që është tatimi i të ardhurave nga dividendi. Unë ju kam drejtuar disa pyetje, zoti kryetar i di, por për ato pyetje ministria thotë se duhen 2 muaj të kthejë përgjigje.

Eduard Shalsi – Nuk ka mundësi të dojë 2 muaj.

Ilir Beqaj – Pyeteni, ashtu më tha.

Eduard Shalsi – Për pjesën që lidhet me dividendin, jo për pjesën tjetër, ai duhet të jetë informacion i gatshëm për sa kohë kanë ardhur te...

Nikolla Lera – Unë doja ta lexoja përsëri tani, por nuk dua të tërheq vëmendjen. Për një periudhë 10-vjeçare...

Ilir Beqaj – Jo, që nga viti 2012.

Nikolla Lera – Pra, nga viti 2012 deri në vitin 2017, duhet që ne të hapim çdo bilanc dhe të marrim vendimin dhe të shikojmë sa ka kapitalizuar, sa ka lënë në formën e rezervave dhe sa ka shpërndarë në dividend. Tani mendoni, duhet të hapen 20 mijë bilance me 7 vjet, sepse nuk e kemi të informatizuar.

Eduard Shalsi – Pse nuk është informatizuar kjo pjesë?

Nikolla Lera - Jo, nuk e kemi të informatizuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi - Për shembull, pse shkon dhe bën analizat te mjeku?

Robert Bitri – Nuk është ashtu.

Eduard Shalsi – Po të bëj një pyetje.

Robert Bitri - Logjika juaj është sa të grumbullojmë.

Eduard Shalsi – Si sa të brumbullojmë?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E dini pse është pyetja në mënyrë që ne të marrim informacion. Unë nuk e di nëse ministria ka të drejtë, apo ka të drejtë zoti Beqaj, apo ai që kundërshton. Dua të di analizat përpara se të them ty për mëlcinë, për shprektën, për njërën apo tjetër, pra unë kam nevojë për disa të dhëna analizash. Ajo që ka kërkuar zoti Beqaj është një minimum i domosdoshëm qysh para se ato të vinin me propozimin për çuar nga 15 të 10.

Urdhëroni!

Ilir Beqaj – Ka një perceptim, nga janari i vitit 2014, kur ne kaluam nga regjimi fiskal 10 vjet në 15-15, ka pasur një prirje të bizneseve për të mos tërhequr dividend dhe për pasojë, mund të kenë rënë të ardhurat nga dividendi. Për sa kohë janë me mund, unë kam kërkuar një informacion pak më të plotë. Çfarë ndodh me fitimin? Me fitimin tri gjëra ndodhin: ose rrit kapitalin, ose shpërndahet ose shkon në rezerva. Këto janë tri vendet, ku mund të shkojë. Për të kuptuar çfarë ndodhi, si u soll biznesi 15-15, a ka mundësi të kemi disa shifra? Si ishte 2 vjetët e fundit dhe çfarë ka ndodhur në këta 4 vjet? Nuk i kam thotë, por t'i nxjerrë.

Nikolla Lera – Ju lutem, më lejoni t'ju sqaroj! Ne mund t'ju vëmë në dispozicion, sepse i kemi. Para se të bënim këtë projekt ne mbi bazën e shifrave dhe të analizave e bëmë. Pra, në mënyrë elektronike ne mund t'i sjellim nga viti 2014, që janë në sistemin e ri.

Ilir Beqaj – Mua më duhet si ka qenë më para. Nga 2014 e mbrapa është në regjistër, nuk ndryshon gjë.

Nikolla Lera – Ne mund t'ju japim sa ka qenë fitimi i deklaruar i kompanive totale, ose, po të donin, edhe për çdo kompani. Sa ka qenë taksa për fitimin e kaluar, sa është fitimi

pas tatimit për çdo kompani, sa ka qenë dividendi që ka deklaruar që ka shpërndarë dhe sa është...

Ilir Beqaj – Që ta kuptoj unë, kur ndryshon sjellja, apo jo? Më jep numrat të shikoj si ka ndryshuar

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nikolla Lera – Zoti Beqaj e kërkon të detajuar, pra që këtu duhet të hapim çdo vendim për destinim fitimin.

Ilir Beqaj – Kam kërkuar edhe diçka tjetër: sa nga këto janë kompani të huaja, që do ta çojnë jashtë, sepse po bëjmë një politikë që të ikin lekët jashtë Shqipërisë?

Nikolla Lera – Pra, të modifikuar kërkesën e deputetit ne mund ta realizojmë. Për shembull, këtë që thashë unë, mund t'ju themi sa ka qenë fitimi, fitimi mbas tatimit, dividendi i deklaruar dhe shuma që ka mbetur pas dividendit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për të gjetur këtë fitim pas dividendit e ka çuar në rezervë, apo e ka çuar në shtim kapitali, apo e ka lënë, këtu duhet të hapim çdo vendim, sepse nuk e kemi të hedhur në mënyrë analitike. Do të hapim çdo vendim për të gjitha vitet.

Ilir Beqaj - Edhe një herë, unë nuk e di si keni arritur në atë përfundim pa pasur këto të dhëna.

Nikolla Lera – Ne kemi bërë një analizë të dividendit dhe të taksdividendit për vitet 2015, 2016 dhe 2017. Çfarë rezulton? Rezulton se fitimi në këta 3 vjet i deklaruar i 20 mijë kompanive ka qenë X lekë, nga ky fitim kemi zbritur tatimin mbi fitimin që kanë paguar dhe na ngelet fitimi pas tatimit. Nga kjo kemi zbritur dividendin, që kanë deklaruar, dhe pasi kemi zbritur edhe dividendin e deklaruar, na ngelet një shumë prej rreth 395 miliardë lekësh, që është për këta tre vjet, ose e bashkuar me kapitalin, ose e lënë në formën e rezervave, sepse në këto dy poste lejohej subjekti. Pra, për këtë 395 miliardë ne nuk e dimë nëse është lënë në rezerva apo është bashkuar me kapitalin, sepse na duhet të hapim çdo vendim.

Ilir Beqaj – Si ka qenë më parë, kur sistemi ishte 10 vjet?

Nikolla Lera – Edhe vitin 2014 ne mund ta nxjerrim.

Ilir Beqaj – Më duhet më parë, kur ishte 10 vjet.

Nikolla Lera – Na duhet të hapim cdo bilanc.

Ilir Beqaj – Dakord. Ju thatë 395 miliardë,...

Erion Luci – Tatimi mbi të ardhurat personale rritet në masën 37,4 miliardë lekë, duke e shtuar rritjen me rreth 0,6 miliardë lekë, 1,6% më shumë se bashkimi i të ardhurave, të ardhura nga kjo taksë...

Ilir Beqaj – Aty janë edhe të ardhurat nga pagat, kështu që nuk i ndan ai. Aty është edhe burimi i pagës dhe ai është kryesori, dividendi është më pak.

Nikolla Lera – Në fakt, për hir të së vërtetës, dividendi i paguar në vitin 2018, për llogari të bilancit të vitit 2017 kishte një rritje duke e krahasuar me dividendin e paguar në vitin 2017.

Ilir Beqaj – Sa për qind?

Nikolla Lera – Ne mbledhëm sivjet 3,6 miliardë nga 3,2 një vit më parë, domethënë rreth 500 milionë më shumë, 10-12% më shumë.

Ilir Beqaj – Ju thoni se do ta ulim nga 15 në 8. Së pari, bëni mirë, sepse po mbajmë angazhimin programor. Ajo që unë personalisht nuk jam gati të mbështes, është fuqia prapavepruese. Në një mjedis laborator ai hyn në fuqi nga 1 janari 2019 dhe për mua ka efekt në vitin 2020, kur të ndahet fitimi i vitit 2019. Nga kjo normë, vitin e ardhshëm, që praktikisht është amnisti, pretendon të fitosh 4,5 miliardë, që do të thotë se nga mbrapa ka 56 miliardë. Do të mbledhësh 4,5 miliardë, që është 8% e një totali, i cili është 55 miliardë. Pra, këto 55 do t'i marrësh nga 395, që kanë ngelur stoqe, kur vetëm këtë vit paske marrë 3,6. Si ka mundësi që këtë vit 3,6 me 15 dhe vitin tjetër me 8, me 4 vjet amnisti 4,5?!

Nikolla Lera – Po, sepse, sikurse ju thashë, janë 395 milionë që kam llogaritur për tre vjet të mbartura, por ne nuk kemi nivel sigurie që të themi sa për qind e tyre është bashkuar me kapitalin, ose sa për qind subjekti nuk do ta shpërndajë. Pra, ky është vlerësim dhe ju nuk jeni në gjendje ta bëni këtë analizë.

Ilir Beqaj – Së dyti, u shprehët që përfitojnë 15 mijë biznese dhe rreth 50 mijë ortakë.

Nikoll Lera – Me një numër mesatar.

Ilir Beqaj – Në faqen 3 të relacionit ju thoni 20 mijë.

Nikoll Lera – Duhet të jetë gabim.

Ilir Beqaj – 20 mijë me 15 mijë nuk janë gabime të vogla.

Nikolla Lera – Zoti Beqaj, po jua shpjegoj diferencën 5 mijë. Në 20 mijë biznese, 5 mijë kanë status person fizik, të cilët nuk bëjnë deklaratë dividendi.

Ilir Beqaj – Kur bë më ndryshimin nga 8 në 14, thamë që mbi 8 janë 22 mijë...

Nikolla Lera – 12500 përfitojnë.

Ilir Beqaj – Atëherë, kanë ngelur 8 mijë, sepse këta nuk do të marrin vitin tjetër edhe 5%, edhe si dividend.

Nikolla Lera – Kur ulëm normën e tatimit nga 15% në 5%, ne kishim parasysh vetëm grupin që është te biznesi i madh, pra 20 mijë. Nga kjo 20 mijë, që taksohej me 15%,

11400 prej tyre i kishin të ardhurat që deklarorin në vit më pak se 14 milionë lekë, sepse jo domosdoshmërisht një kompani ka shifra të larta, ka edhe kompani të vogla. Pra, nga 20000, 11400 do të paguajnë 5%, ndërsa 9000 do të paguajnë 15%, ashtu siç paguanin.

Ilir Beqaj – Domethënë, nga 1 janari i vitit 2019, 9500 kanë ngelur në vlerën 15%.

Nikolla Lera – Po, por në regjimin e dividendit kanë ngelur 20000.

Ilir Beqaj – Dakord, ua dhamë 15/5, do u japim 15/8 dhe amnistinë e 4 vjetëve?! A nuk është shumë, Niko?

Nikolla Lera – Nuk mendoj se është shumë, sepse ne hoqëm lojërat e fatit dhe realisht ne do të humbasim 7 miliardë lekë.

Ilir Beqaj – Nuk më duhet mua se çfarë bën me lekët, unë po flas për politikën që bën me shtresat e ndryshme të popullsisë. Nuk merrem unë me arkën, ajo është thesar dhe gjeje ku të duash!

Nikolla Lera – Është thesar, por duhet të kompensohen të ardhurat që humbasin.

Ilir Beqaj – Ne kemi fashën, që u bënë një lehtësi, ku nga 15% ua zbritëm në 5% dhe do t'ua bësh 8 dividendin për vitet e kaluar?! Kush janë ata dhe çfarë merite kanë ata në shoqërinë shqiptare, a mund të ma thuash? E di kush përfiton më shumë nga këta?! Jo ai i shkreti që e ka normën 5%, por noterët, avokatët, ekspertët kontabël, përmbaruesit, arkitektët....

Nikolla Lera – Këta janë persona fizikë dhe askush nga ata nuk ka paguar taksë mbi fitimin, të jeni të sigurt.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Ju nuk keni norma fitimi 60%, siç ka një që bën konsulencë. Ai ka vetëm veten dhe ka fitim sa të duash. Kush është kjo shtresë e popullsisë, e cila meriton këtë përkëdhelje nga ana jonë? Unë nuk e kuptoj logjikisht dhe nuk po merrem me hesape, sepse ju mund të thoni: “Unë kam këto lekë dhe dua të bëj TVSH-në nga 20-21 që të kuadrojë”.

Niko, ka diçka, ndoshta ne nuk kemi një ide të qartë se çfarë është shtresa e mesme, sepse nuk janë 10 mijë familje nga 700 mijë.

Nga 1,3 milionë e çoni në 1,5 milionë. Së pari, keni një gabim në llogaritje, sepse nuk e keni 20 mijë lekë në muaj.

Nikolla Lera – Përfitimi është 24 mijë lekë.

Ilir Beqaj – Jo, e ke më pak, sepse po ta llogarisësh 24 herë 15400 të del 360 milionë, ndërkohë ju thoni 310 milionë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, por totali është 360, jo 310 dhe mesatarisht është 16 mijë lekë të vjetër në muaj, sepse ka edhe njerëz që janë me 1,4, prandaj të del ajo mesatare. A mund të më thuash se kush është përfitimi i atyre njerëzve, por edhe yni politik që 15 mijë njerëzve ua rrisim pagën neto me 1,7%? Kjo rritje me 1,7% nuk i leverdis njeriu dhe ne na vë në kurriz 200 mijë vetë, të cilët thonë: “Të jemi edhe ne si deputetët, sepse ata e bëjnë për rrogat e tyre”, kjo do të jetë fjala e parë. Edhe unë, po të jem në opozitë, e kam të thjeshtë të merrem me këtë.

Eduard Shalsi – Për ty nuk janë shumë, por për të tjerët...

Ilir Beqaj – Janë për 15 mijë njerëz të shtresës së lartë. Shpenzimet mujore të familjes shqiptare janë 700 mijë lekë. Niko, është ideologji, nuk është kuadrim.

Nikolla Lera – Ti i ke incentivuar 400 mijë të punësuar me paga të ulëta 0%-30 mijë lekë...

Ilir Beqaj - Pas pesë vjetësh 300 mijë lekshi bëhet 350, ka inflacion. Mos u shmang. Niko dua përgjigje për këtë, sepse ka 5 vjet që e kanë 300 mijë lekë, a nuk duhet të shkojë 330?! Nëse e çon 330, e votoj unë 1,5%

Nikolla Lera- Po, ndikim ka. Në segmentin 30000-40000 kemi rreth 60 mijë të punësuar dhe në qoftë se do të bëjmë këtë lëvizje, ajo ka efekt.

Ilir Beqaj – Dyshemeja duhet rregulluar me kosto jetese për 6 vjet? Atëherë, për 6 vjet 10%, ku inflacioni mund të shkojë 15 akumulativ. Unë e mbështes 1,5% nëse ti je dakord që ta bësh nga 300-330. Për çfarë bën 1,5%, për 15 mijë vetë që u rrit pagën neto 1,7%? Nuk e rrit konsumin dhe nuk u bën nder atyre. Pse duhen ndihmuar këta 15 mijë persona me 16 mijë lekë të vjetër në muaj, të cilët e kanë 1,4% të rrogës mujore?

Te renta unë kam këto shqetësime: përveç logjikës që keni ju, që po na shterojnë rezervat e kromit dhe kjo na bën që ne të fenojmë nxjerrjen, duhet të bëjmë një vlerësim pak më të pjekur. Çfarë do të ndodhë me punësimin aty? Sipas anketës së buxhetit familjar, Dibra është qarku më i varfër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nga 6 shkon 9 dhe mund të fenojë punësimin aty.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Problemi është që vërtet nga njëra anë nuk kemi pse ne t'i shterojmë rezervat, që janë për shumë vjet, por nga ana tjetër, në krahasim me para 5 vjetësh, uzinat që bëjnë ferrokrom i kanë rritur kapacitetet dhe ferrokromi shkon në Europë, ndërsa kromi në Kinë dhe është shumë i varur nga luhajtjet. Unë kam frikë se me këtë që po i bën Trampi Kinës, kërkesa kineze për krom do të bjerë edhe më shumë, pra, mirë është që ta drejtojmë drejt ferrokromit.

Unë kam disa shqetësime. Shqetësimi i parë është se mos ndoshta ka një frenim atje, prandaj kam kërkuar të dhëna nga ministria për të parë ndër vite dhe shqetësimi tjetër lidhet me imponimin e çmimit, sepse ferrokromi dy fabrika ka dhe ata të dy mund t'i fusin një kartelë dhe imponojnë çmimin. Shqetësimi i tretë lidhet me kromin e varfër 12%. Nuk ka kuptim që edhe kromi i varfër 12%, edhe kromi i mirë i Bulqizë dhe Batrës, i cili është 36-38% të kenë të njëjtën ngarkesë rente, nuk e diferencon projekti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vlerat nuk janë, por ngarkesa është ajo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ata dritëshkurtër janë dhe punojnë për 6 muaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka vlerë të shtuar dhe je shumë më pak i varur nga koniunktura e Kinës.

Besnik Baraj- Lidhur me bazën, përqindja është e njëjtë, por në qoftë se përmbajtja e kromit në mineral është tri herë më e vogël se e asaj, edhe baza është tri herë e ndryshme?

Ilir Beqaj – Edhe çmimi ashtu është, sepse është çmim burse.

(Reagime pa mikrofon)

Besnik Baraj – Po të jetë tri herë edhe diferenca, atëherë ka logjikë.

Ilir Beqaj – Nuk e dimë, se ajo është çështje burse pastaj.

Nikolla Lera – Unë nuk e di se sa është ekzaktësisht, por kjo logjikë përdoret, sepse dogana i përdor këto çmime në bazë të përqindjes. Pra, nëse ka të dhënë e çmimit të X burse me 40%-42% dhe kromi ynë është me përqindje më të ulët, për ato përqindje që ulet, diferencon dhe ul çmimin. Natyrisht, për 12% është shumë më e ulët se për 42 %.

Ilir Beqaj – E diskutova paradite edhe me zotin Luçin, me zëvendësministrin. Në fakt, unë e kisha lexuar në mënyrë naive relacionin, por edhe ajo që më tha ai ma vrau veshin. Ju mendoni të zhdoganoni vitin e ardhshëm 200 tonë më shumë cigare. Unë e pyeta nëse do të rritet konsumi? Jo, ai tha se është çështje e uljes së kontrabandës. Akoma e kemi kontrabandën e duhanit në këto nivele ne? Unë po them përgjigjen që më tha ai. Unë vetë mendova...

Nikolla Lera – Me cigaret ne vazhdojmë luftën kundër evazionit. Vazhdojmë të kombinojmë politikat fiskale me kontrollin në terren. Krahasuar me vitin 2017, në vitin 2018 kemi një ngërç që nuk po arrijmë sasinë e projektuar. Pra, kemi projektuar 3200 tonë për vitin 2018, me vlerësimet tona, të cilat mund të jenë edhe të gabuara, sepse nuk e di me saktësi se cila do të jetë ecuria, mund të jemi te 3000 tonë. Për vitin 2019 ne nuk mund të rrimë te 300 mijë tonë, kështu që kemi planifikuar 200 tonë më shumë, pra 3200 tonë. Cila është

problematika?! Problematika është shumë komplekse. Për shembull, megjithëse ne kemi lënë nivel të ulët akcizë të prodhimit vendas, ne kemi problematikë të madhe me prodhimin e vendit. Kompanitë që importojnë, të cilave ne u bëjmë presion pse ka rënë importi, na akuzojnë se 1500-2000 është konsumi i duhanit nga prodhimi i vendit, të cilin ne nuk po mundemi ta menaxhojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë 1500 tonë që nuk akcizohen dhe që nuk i kontrollojmë dot. Pra, prodhohet, bëhet cigare dhe shitet duke mos paguar akcizë. Ne këtë u kërkojmë. Këto kompanitë e mëdha kanë bërë studime dhe na thonë: zotërinj, ju keni 1500-2000, nuk e di sa të sakta janë studimet e tyre, duhan të paakcizuar, pra merruni me këta dhe jo me ne. Domethënë, jemi në një situatë....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, prodhimi i deklaruar nuk është 1000 tonë.

Robert Bitri – Sa është i deklaruari?

Nikollla Lera – I deklaruari është në një sasi minimale. Besoj se është në 15-20-30 tonë duhet të jetë. Madje as kaq nuk do të jetë. Po shoh shifrat.

(Diskutime pa mikrofon)

Më falni, te ky vlerësimi që bëjnë kompanitë mund të përfshihet edhe duhani, që vjen kryesisht në zona si Shkodra, pra është kontrabandë kufitare.

Eduard Shalsi – Për rentën a ka kërkuar ndonjë grup interesi një dëgjësë me ju?

(Reagim pa mikrofon)

Ka një edhe shoqata e investitorëve të huaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Përveç kësaj, ka pasur një kërkesë në lidhje me një shqetësim tjetër përsëri në lidhje me rentën. Kishte të bënte me faktin që, duke qenë se tani do të incentivohet përpunimi vendas, në krahasim me eksportin bruto, duhet që shteti të normojë dhe të vendosë disa rregulla midis atyre që e nxjerrin dhe fabrikave, sepse mundet që tani fabrikat e përpunimit të diktojnë dhe të imponojnë çmimet. Këtë ma ka sugjeruar dikush. Nuk e mbaj mend se cili nga ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po flet për përfitimet e pushtetit vendor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndarja e rentës.

Nikolla Lera – 5%.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Nuk është asnjë gjë, por debati ka qenë tek efienca e përdorimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky është një debat i madh filozofik. Niko, dua të mbani shënim këtë, derisa ta gjej unë nëse e kam me shkrim apo verbalisht shqetësimin. Në momentin kur ne po marrim disa masa të cilat....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë që ta mbarojmë pak këtë, sepse dua ta mbajë shënim Niko. Pra, do ta gjej nëse e kam me shkrim apo verbalisht. Shqetësimi është: meqenëse po icoentivojmë përpunimin dhe demoralizojmë eksportin bruto të minerareve, duam të gjejmë një mekanizëm, në mënyrë që fabrikat e përpunimit, që do të blejnë mineraret, të mos abuzojnë me çmimet. Se si normohet, këtë nuk di ta them, por tashmë do të jenë të nxitur prodhuesit, nxjerrësit e minerareve që ta çojnë. Fabrikat e përpunimit janë me gishta dhe duhen inkurajuar investimet, por nga ana tjetër duhet frenuar abuzimi. Ky është një shqetësim, të cilin ne duhet ta adresojmë me njëri-tjetrin.

Ilir Beqaj – Dua të bëj një parantezë, por këtu besoj se për këtë është i gjithë komisioni i interesuar. Nuk e di se kur do ta diskutojmë çështjen e inputeve bujqësore. Paketa kjo është. Kryeministri ka thënë dje në mbledhjen e grupit se, pavarësisht se si ka ardhur projekti i qeverisë, aty çështja është ende e hapur për diskutim. Po ju pyes në parim, sepse e vendos kryetari se kur do ta hapim këtë temë.

Nikolla Lera – Unë dua t'ju sqaroj, zoti deputet, në lidhje me këtë çështje. Ne kemi krijuar incentiva jo të vogla për bujqësinë. Pra, është e vërtetë që inputet bujqësore, fara fidanët apo ku di unë të përjashtohen nga TVSH-ja, por ne po ia financojmë indirekt fermerit këtë, sepse po i rimbursojmë 20%. Domethënë, çfarë tregojnë shifrat? Eksportuesit që mbledhin nga fermerët dhe eksportojnë apo përpunuesit, EHW-ja, KMY-ja apo fabrikat e prodhimit të produkteve blegtorale e quajnë sikur kanë paguar nëpërmjet autofaturimit, blerjeve të fermerët 2,4-2,5 miliardë në një vit. Kjo do të thotë se bujku financohet me 22 milionë dollarë në vit nëpërmjet skemës së 20% të TVSH-së, pra 2,5 miliardë në vitin 2017. Çfarë nënkupton kjo?! Kjo nënkupton jo vetëm që këta fermerë kanë marrë 20% e inputit të farës, të fidanit, të punimit me makineri, por kanë marrë edhe TVSH-në e punës së tyre, sepse ne i japim fermerit 20% të çmimit të shitjes.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po të them edhe një herë: prodhuesit dhe eksportuesit kanë kredituar 2,5 miliardë lekë.

Ilir Beqaj – E di cili është shqetësimi ynë?! Ato lekë nuk shkojnë te fshatari.

Nikolla Lera – Atëherë, të ndryshojë skema.

Ilir Beqaj – Skemën ne e bëjmë, pra ju dhe ne. Ky është problemi.

Nikolla Lera – Ne me letra u japim fermerëve 2,5 miliardë lekë. Kjo është shifra.

Robert Bitri – Ti i jep atij që shet TVSH-në e eksportit, por kushdo që eksporton e merr TVSH-në. Pse e quan ti sikur këtë e marrka fshatari? Fshatari, sipas teje, nuk duhet ta shesë mallin? Nuk është muhabeti që ti e shet mallin, ky e shet me dy lekë, ti i thua që do të japim 2,5 ty dhe ia kompenson këtij tjetrit. Jo, ky e shet me dy, fshatari nuk merr gjë. Ky që eksporton, merr TVSH-në eksportit. Ai nuk i jep gjë fshatarit, por ia blen me çmim...

Nikolla Lera – Ai nuk i ka paguar fshatarit TVSH, pse duhet të kreditojë TVSH? Atëherë, le të ndryshojmë skemën.

Eduard Shalsi – Ka dy elemente të propozimi i inputeve bujqësore: një është incentivimi, por gjëja më e rëndësishme është se ne kemi probleme madhore, sepse ka një informalitet të lartë; e dyta, jemi komplet jashtë tregut me vendet e rajonit dhe, e treta, cilësia jashtëzakonisht e dobët. Kjo do të thotë se kemi arritur një konkluzion dhe unë kam edhe një objeksion timin. Pavarësisht se jam mbështetës i heqjes së inputeve, kam vite që kërkoj një *track&tracing* për të gjitha këto produkte që janë si ilaçet, domethënë kanë impakt të jashtëzakonshëm në mënyrën se si ushqehemi dhe sigurinë ushqimore, pra kanë edhe një pasojë shumë të rrezikshme për shëndetin. Një masë e tillë jam e bindur që nuk do të ishte e plotë pa një rekord nga futja dhe deri tek ai që e shet. Nga ana tjetër, përveç mbështetjes, do të doja të merrnit në konsideratë edhe faktin që në këtë treg abuzohet shumë, ka informalitet, dhe nëse Maqedonia, vendet e rajonit janë me TVSH shumë të ulët, disa e kanë edhe zero, atëherë si mund t'i konkurrojmë ne? Pra, duhet parë pak më gjerë.

Nikolla Lera – Jam plotësisht dakord me ju, por ajo që unë mendoj është se ne mund t'i përjashtojmë inputet bujqësore nga TVSH-ja në import apo nga prodhimi i vendit, por nuk besoj të ketë inpute që prodhohen brenda vendit dhe të heqim skemën e 20% për fermerin, meqenëse ajo është skemë abuzuese. Pra, ne e lirojmë fermerin nga pagesa e TVSH-së për inputet bujqësore dhe, njëkohësisht, heqim abuzimin, që edhe ju e thatë. 2,5 miliardë i marrin shtetit eksportuesit dhe prodhuesit.

Ilir Beqaj – Personalisht, meqenëse u hap kjo temë, po ju them vlerësimin tim individual pse nuk e mbështes heqjen e TVSH-së inputeve, edhe pse kam qenë dakord për të para 5 vjetësh. Ne kemi gjykuar 4-5 problemet kryesore që ka moszhvillimi i bujqësisë në Shqipëri: mungesa e certifikatës së pronësisë, vadtja, kostot e larta të inputeve, sidomos të mekanikës dhe mungesa e një zinxhiri të mirë tregu. Pak a shumë këto janë gjërat kryesore që

kemi thënë. Bazuar në informacionin që na thonë këta, që merren me këtë punë. Po të hiqet kjo TVSH, kushton 10 milionë euro; kështu thonë këta.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por kaq thonë tani. Pa ma thuaj sa është?

Eduard Shalsi – Aq.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, mor, jo të inputeve bujqësore.

(Diskutime pa mikrofon)

Edhe një herë, se kemi një të dhënë tani, që është 9 pikë ca milionë euro.

Ilir Beqaj – Zoti Ndraçi, unë e bëj arsyetimin edhe me dhjetë, edhe me gjashtëmbëdhjetë, që është jotja, nuk e kam problem, por ta vazhdojmë me dhjetë një herë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jam kundër!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po ta them pse.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Muhabet po bëjmë, mor burrë, tani!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pikërisht pra, se nuk do të bëjmë gjë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Vullnet, të lutem!

Ilir Beqaj – Nuk do të bëjmë gjë, se këtë merak kam unë, më lini ta zhvilloj...!

Eduard Shalsi – Unë jam partizan i asaj, them që ta dish, meqenëse thua lëre, dhe do ta mbështes iniciativën, por, nga ana tjetër, ka një pikëpyetje shumë të madhe, sepse...

Ilir Ndraxhi – Hajde ta diskutojmë.

Eduard Shalsi – Ja pra, këtë 20% nuk e kanë përfituar fshatarët! E kemi marrë si masë dhe nuk e kanë përfituar rimbursimin!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atë 20%-shin, autofaturimin!

Ilir Beqaj – Zoti Ndraçi, ta vazhdoj pak arsyetimin?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bert, ta mbaroj, o burrë, tani!

Robert Bitri – Vetëm një minutë!

Ilir Beqaj – Dakord.

Robert Bitri – Çdo njeri që eksporton, merr TVSH-në mbrapsht?

Ilir Ndraçi – Patjetër, në qoftë se ka paguar TVSH-në, e merr mbrapsht.

Robert Bitri – Po, mirë, se ka një pikë fillimi ajo.

(Deputeti Bitri flet pa mikrofon.)

Ky fshatari nuk po ia jep. Si çdo eksportues, edhe ky që grumbullon, merr TVSH, pra nuk ia lë fshatarit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shesim mend kot që ia japim fshatarit. Ç’do me thënë ia japim fshatarit? Fshatari prodhon domaten, e shet me çmimin 10 lekë ose sa t’i thotë ai...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dhe mbyllet këtu pjesa e fshatarit, ndërsa ky tjetri e merr domaten, fillon e eksporton... Me çmimin që është në treg.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me 12 lekë.

Ilir Beqaj – Ne i japim 2 lekë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Robert Bitri – Jo, ne i japim tani 20% të 2-shit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

2 milion, 0,2.

Ilir Beqaj – Jo, mor, 2!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Robert Bitri – Dakord, 2 lekë.

Ilir Beqaj – 20 mijë të 12-tës.

(Deputeti Beqaj flet pa mikrofon.)

Robert Bitri – 2 lekë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duro, mor tani, ne themi që këtë e ka marrë fshatari!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Mos më ndërprisni edhe pse mund të mos jem shumë i qartë teksa e shpreh!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për farat e kam.

Themi se është 10 milionë. Nëse është 10 milionë, xhiroja është 50 plus 10 TVSH-ja; shkon në 60 milionë. Ndërsa ti po thua se është 100. Edhe 100, do ta pranojmë. Qoftë nëse

është 60, qoftë është 100, TVSH-ja është nga 10 milionë në 16 milionë, sepse një e gjashta është TVSH.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani, prodhimi bujqësor shqiptar në vitin 2017, po të heq peshkimin dhe pyjet, është 2,2 miliardë euro. Kjo do të thotë se...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, 2,2 miliardë euro.

GDP-ja është 13 miliardë, aq është, 18%. Kjo do të thotë se inputet bashkë me TVSH-në e paskan koston nga 3% në 4% të të gjithë prodhimit bujqësor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani, për kaq po flasim? E marrim ndryshe. Do t'u japim atyre ndihmë, praktikisht 16 milionë euro, po e heqim. Pra, 16 milionë, sa thua ti. Unë besoj se 150 mijë janë fermat aktive, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

100 euro...

(Diskutime në sallë)

Eduard Shalsi – A e kupton se jemi në tymnajë me shprehjen që the?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë disa që thonë: 36 mijë, disa të tjerë thonë 280 mijë, disa thonë 300 mijë, ndërkohë janë edhe disa që thonë 360 mijë. Në këtë komision këtu...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë kundrejt, mor?! Këtu thotë: 150. A e kupton? Ne, përpara se të diskutojmë këto, duhet të themi: nuk marrim asnjë vendim për sa kohë nuk vjen informacioni sa ferma dhe fermerë ka në Shqipëri!

Vazhdo pra, atëherë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të orientojmë debatin!

Ilir Beqaj – Një sekondë!

Familjet fshatare që jetojnë në fshat përbëjnë 22% të popullsisë. Nga 700 familje që ka Shqipëria, janë 290 familje. Po t'i heq familjet me ndihmë ekonomike, që janë nja 30 mijë në fshat...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë ke tani?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Problemi është ky.

Eduard Shalsi – Ngrini dorën dhe thojeni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Problemi është ky. Unë mendoj se kjo lehtësi prej 16 milionë eurosh, që po duam t'ua japim fshatarëve, me shpresën që çmimi do të ulet, kjo është pikëpyetje, por po e marr...

Vullnet Sinaj – Do të ulet çmimi, është e sigurt, se është ekonomi tregu, mor burrë, është konkurrenca: kërkesë-ofertë!

Ilir Beqaj – Madje e marrim 16 milionë, për 250 mijë i bie se po i ndihmojmë me 100 euro në vit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për aq ka ngel fshatari shqiptar?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për 100 euro në vit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – 100 euro në vit?!

Burrë – Për familje kaq i bie.

Eduard Shalsi – Absolutisht.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, mor!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ore, ke shkuar ndonjëherë në fshat, apo jo?!

Fjalën e ka zoti Sinaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është e vonë, është lehtësi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për 100 euro?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Ndraxhi – Zoti Beqaj, e keni gabim, nuk është 100 euro!

Ilir Beqaj – Sa është, atëherë?

Ilir Ndraxhi – Unë insistoj dhe vazhdoj të them se vlera e TVSH-së është mbi 20 milionë euro.

Ilir Beqaj – Tani, nga 100, është 60!

Ilir Ndraxhi – 100 milionë është vlera bruto.

(Deputetët flasin njëkohësisht.)

100 milionë është importi.

Eduard Shalsi – Në rregull, zoti Ndraçi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Në qoftë se vlerën e hyrjes në import e ka 100 milionë, atje shitet 130.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, por është edhe kostoja kur tregtohet!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Po, po, ja tani!

Vullnet, vazhdo.

Ilir Beqaj – Unë nuk mbarova.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Prandaj po them...

Ilir Beqaj – Ose jo, meqenëse e kam çështje jashtë bujqësisë, tërhiqem dhe pres radhën më vonë!

Eduard Shalsi – Në rregull.

Po, zoti Sinaj.

Vullnet Sinaj – Atëherë, në qoftë se flasim...

Eduard Shalsi – Vetëm se një gjë, për bujqësinë, duhet të rakordojmë me njëri-tjetrin që të mos flasim në hava, sepse ne kemi nevojë të marrim disa vendime lidhur me një informacion...

Vullnet Sinaj – Ky ikën dhe nuk dëgjon, ore!

Eduard Shalsi – Në rast se ti merr si referencë 150 mijë ferma dhe ne në këtë komision kemi dëgjuar tri herë zyrtarisht nga përfaqësuesit e ministrisë shifrat: 340 mijë, 300 mijë dhe 250 mijë, madje e fundit fare, zoti Tarelli tha: “Jo, nuk bëhet fjalë aq, sepse në Shqipëri ka 35 mijë ferma”, atëherë baza mbi të cilën ne gjykojmë është krejt objektive.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kështu që, rrahim ujë në hava.

Ilir Beqaj – Unë mund ta pranoj që flas në hava.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, një moment!

Eduard Shalsi – 150 mijë the.

Ilir Beqaj – Ja t’jua them edhe pse është 150 mijë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë të thashë sa familje ka Shqipëria.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Si?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Ju thashë sa familje ka Shqipëria, sa prej tyre jetojnë në fshat, të zbrita familjet me ndihmë ekonomike? Nga ky stok që të ngelet, 35 janë ato që kanë marrë NIPT fermeri. Por këtu shumica janë pa NIPT fermeri dhe përsëri janë në bujqësi.

Eduard Shalsi – E çfarë do të thotë kjo?

Ilir Beqaj – Se nuk flas në hava, se prandaj të fola për 150-ën!

Robert Bitri – Pra, ti thua se nuk janë 35.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Ore, një sekondë tani!

Ilir Beqaj – Ja t’jua them pse nuk janë 35! Sepse kjo pjesa tjetër, nga 200-a në 150, është ende pa ia rregulluar ne vadingjen.

Kemi ngelur te 210-mijëshi, por duhet të shkojë 280 mijë hektarë që ta vadis.

Eduard Shalsi – Po, pra, kjo është aritmetikë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Ama, nuk flas në hava!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Është teorike.

Ilir Beqaj – Kjo nuk është në hava!

Eduard Shalsi – Jo, mor, kjo është komplet hava!

Ilir Beqaj – Nuk është në hava...!

Eduard Shalsi – Është, mor!

Ilir Beqaj – Për sa kohë nuk kam *database*, unë do të arsyetoj, sepse nuk mund të krijohet *database*-i për dhjetë vjet!

Eduard Shalsi – Jo, mor, jo, ti e ke *database*-in, i cili të jep tri shifra: 340, 300 dhe 250! Kjo është ajo!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Deklarata verbale atje është e gjitha.

Tani, ne po flasim për...

Ilir Beqaj – 35-a është me NIPT fermeri, mor!

Eduard Shalsi – Ky është hamendësim përsëri.

Ilir Beqaj – Ligji i fermerit është tatim!

Eduard Shalsi – Në qoftë se ne do të klasifikojmë disa prioritete dhe në qoftë se do të mbanim mend një gjë për vitin 2018, për shembull, do të ishte pikërisht kjo: vendosëm rregull në librat e bujqësisë. Pastaj, do të themi: do të afektojmë 10% të fermerëve, kjo masë afekton 20%, kjo bën këtë, kjo bën këtë e të tjerë me radhë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë, Vullnet, vazhdo!

Vullnet Sinaj – Te ky projektbuxhet shkruhet që nuk ka arritur të jenë subvencionet.

Eduard Shalsi – Si?

Vullnet Sinaj – Te ky projektbuxhet thuhet se nuk kanë arritur t'u jepen të gjitha subvencionet...

Eduard Shalsi – Fshatarëve?

Vullnet Sinaj – Po, dhe për arsye të ndryshme.

Por zoti Beqaj ka një gjë të keqe: e dëgjojmë kur flet, por nuk dëgjon kur flasim ne, fillon përsëri nga e para. Ose të vijmë në mbledhje, ose të mos flasim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E ndërpret shiritin tani dhe vazhdon përsëri me pjesën tjetër!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Iku Beqaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Vazhdo tani, Vullnet.

Vullnet Sinaj – Unë jam 100% i bindur se ne do ta ndihmojmë jashtëzakonisht shumë prodhimin bujqësor, do ta heqim këtë barrë nga pagesa në çmim e fshatarëve, e fermerëve, e bujqve. Të mos merakosemi se fitohet çmimi ose jo. Tregu ka rregullat e tij. Nuk të lë konkurrenca.

Nuk mund të bien dakord të gjithë importuesit e lëndëve të para, e pesticideve ose të farave që të mbajnë një çmim; nuk ka shans, nuk të lënë ligjet e tregut. Kështu që do ta përfitojë fshatari, të jemi të sigurt për këtë.

Unë jam pro heqjes së rimbursimit të TVSH-së, që bëhet në eksport, pasi ajo është bërë si monopol. Fshatarët e shkretë, fermerët prodhojnë, por nuk kanë licenca për të eksportuar. Ndaj e çojnë te një pikë grumbullimi, e cila më pas e merr atë produkt atje, e eksporton produktin e atyre fshatarëve dhe rimbursion 20% mbrapsht. Këtë hiqeni! Ky është bërë i tëri manipulim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Vullnet, është bërë betejë për këtë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Që ta marrin këto 20%-shin...

Vullnet Sinaj – Tani, a ka mundësi? Po të flasim nga komisioni, e gjykojmë kështu, ndërkohë po të shkojmë në terren, në Sarandë ose në Berat, atje ku prodhohet, do ta shikojmë se është një person i vetëm që përfiton; nuk përfitojnë fshatarët!

Eduard Shalsi – Jo një person i vetëm, o Vullnet!

Vullnet Sinaj – Një është, Shals, shko në Berat!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Jo, një sekondë tani!

Sapo the dhe je shumë i ndjeshëm karshi eksportit. Dakord?

Vullnet Sinaj – Po.

Eduard Shalsi – Kush e bën eksportin, e bën fshatari, apo e bëjnë pikat e grumbullimit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vullnet Sinaj – E bën një pikë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Një sekondë pra!

Ne kemi bërë një debat disa vjet më parë këtu dhe kemi thënë: “Fshatari merr karburant, fshatari merr, merr, merr” me disa skema, për të cilat ne nuk e dinim përfitueshmërinë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

U vendos një moment dhe u ra dakord që pikat e grumbullimit të mbështeteshin, në mënyrë që të garantohej përthithja...

Vullnet Sinaj – Të ta them...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – A ta lë unë këtë që sapo nisa?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vullnet Sinaj – Ja të mbarojë kryetari.

Më falni!

Eduard Shalsi – Në qoftë se e kapët logjikën, thamë se do t’u krijojmë mundësinë disa pikave që grumbullojnë dhe që eksportojnë. Dakord?

Shifrat e eksportit janë... Ajo ku kemi ngecur tani është që fshatari, i cili duhet të përfitonte 20%-shin me autofaturimin, si dhe që të përfundonte cikli që ne nisëm, që ky 20% që u jepnim atyre të shkonte përsëri te fshatari, ka dështuar. Tani, kjo skemë kur u nis, u nis

pikërisht me këtë logjikë: si të inputeve bujqësore, si me njërën, si me tjetrën të përfitonte i gjithë zinxhiri. Në praktikë doli që përfitoi njëra hallkë, e cila duhet të përfitonte, dhe unë nuk kam kurrfarë dyshimi se pikat e mëdha të grumbullimit janë sot shumë më mirë sesa ishin katër-pesë vjet më parë, falë kësaj politike, por kam pikën e dyshimit se 20%-shi, që ne e nisëm për fshatarin për të autofaturuar dhe ta përfitonte, nuk shkoi tek ai. Pse? Sepse ka çaluar diçka te skema.

Tani, merakun im përsëri tek inputet bujqësore, është që në qoftë se jam i vendosur dhe dua ta mbështes, madje do ta mbështes, pavarësisht se sa i bindur jam tek efekti, ka të bëjë edhe me një element: ne kemi kërkuar disa informacione. Unë jam llahtaritur nga vizita e kolegëve nga Italia, të cilët u futën në një dyqan, ku shiteshin pesticide apo inpute bujqësore, bënë disa foto dhe thanë: “Ju ruajttë Zoti! Në këtë dyqan mund të futet kushdo, mund të blejë çfarë të dojë, mund të mos ketë as regjistrë, asnjë gjë dhe ta përdorë si të dojë tek toka! Kjo është t’u japësh minën disa individëve”.

Tani, pa ndërtuar një sistem... Çfarë kërkuan ata? Ata thanë: “Ore, duhen dy-tre letra të thjeshta që, si farmacia, ashtu edhe dyqanet e inputeve bujqësore duhet t’i kenë”. Pse? Sepse ata gjetën dy thasë, të cilët i fotografuan dhe i dërguan me *Whatsapp*. Pastaj erdhi me charter përfaqësuesi i kompanisë dhe tha: “Kam tre vjet që po kërkoj. Ose prodhohet në Kretë, ose në Turqi, por kjo është minë! Ky thesi këtu nuk është imi, nuk është origjinal!”

Njëri nga propozimet që bëme ishte pikërisht gjurmueshmëria e produkteve dhe baza e të dhënave të të gjithë importuesve: ku e marrin, ku e shesin, si dhe lidhja me dyqanin. Madje dyqani duhet të kishte emrin e fermerit, sepse kryqëzoheshin të dhënat e asaj që subvencionohej fshatari, e asaj që merrte, sa tokë kishte. Pra, në qoftë se merrte një kile më shumë pesticide, nuk përputhej me tokën dhe me produktet që kultivonte, atëherë kishte diçka që nuk shkonte. Prandaj unë them se duhet baza e të dhënave dhe ngritja e një sistemi që, duke kryqëzuar të dhënat, edhe sikur të duash të mashtrosh, të mos arrish të mashtrosh. Për shembull, një fermer në Itali, në qoftë se deklaronte sa energji shpenzonte, e kishte tipologjinë, sepse kishte rekordet e dhjetë vjetve të fundit sa ujë shpenzonte, sa prodhonte, ku e çonte, sa TVSH paguante. Pse? Sepse kishte një mekanizëm kryqëzimi të dhënash, të tillë që nuk e lejonte abuzimin. Ndaj unë them që, sikur një vit të mos bëjmë asnjë investim në bujqësi, por të ndërtojmë një sistem dhe të themi: po, mor vëlla, nga ky moment e tutje do të mbështesim kaq fshatarë; nga ky moment e tutje kaq fshatarë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Robert Bitri – Do të monopolizohej shteti dhe ta bëjë shteti, po pati...

Eduard Shalsi – Zoti Bitri, se keni qenë sekretar komisioni, a e kam sfiduar këtu cilindo që ka ardhur dhe i kam thënë: “Më thuaj sa është sipërfaqja e tokës bujqësore”?

Robert Bitri – Po.

Eduard Shalsi – Hajt e flasim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Robert Bitri – Ja, edhe një herë! Po të më dëgjosh mua, se ne na u bënë monopolet si puna e kooperativave: të mos bëjmë kooperativa, se kanë qenë në kohën e Enverit; të mos bëjmë monopole, se jo kështu, se monopolistët janë hajdutë... Jo, or jo! Bëje monopol, po deshe bëje edhe të shtetit, por kështu kontrollon edhe çmimet; kontrollon edhe cilësinë; kontrollon çdo gjë që ti thua, pra ajo ndjekshmëri e ka më të lehtë praktikën. Në finale ti i thua: po, për këtë gjë dhe ia ul fshatarit dhe e detyron atë t’ia japë shitësit me këtë çmim. Më mirë të fitojë një lek, por të paktën ai e di që e ka të sigurt këtë lek.

Ilir Beqaj – Robert, ka një problem. Të gjitha këto janë “must” në një botë normale, që duhet t’i kishim, por nuk i kemi dhe nuk do t’i kemi as në mbjelljet e kësaj pranvere.

Zoti kryetar, mund të duhet 1 vit për ta ndërtuar atë sistem, por që ta mbushim sistemin me të dhëna, do të na duhen 3-4 vjet. Ai duhet ndërtuar dhe pastaj do kohë që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni!

Hajdeni të ulemi dhe të bëjmë ndryshimet në ligj, por nuk është te paketa fiskale. Ne nuk na pengon asnjëri gjithë vitin t’i bëjmë këto gjëra. Tani vjen paketa fiskale dhe flasim këtu, kur ne nuk na pengonte njeri t’i bënim.

Fakti që nuk i kemi të dhënat, nuk mund të na bëjë të rrimë pa bërë gjë. Aq më shumë, që kemi hyrë në një lojë, ku japim subvencione, kemi skema rimbursimesh etj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Deputet - Ta mbyllim, se kemi nesër prapë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Robert Bitri – Kryetar, 2 herë që fola unë, dole jashtë.

Eduard Shalsi – Nuk është e vërtetë. Unë dola për të folur në telefon.

Robert Bitri – Unë fola 3 herë.

Eduard Shalsi – Ti nuk ke folur 2 herë. Jo, ti e ke kërkuar fjalën 5 herë dhe ke folur 4 herë, që do të thotë se unë të kam dëgjuar 2 herë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Niko, meqë jeni këtu në komision, kam edhe një gjë tjetër, që nuk lidhet me komisionin tonë, por lidhet me shëndetësinë për shpenzimet e rimbursimit. Po ta shtjelloj ty, meqë je drejtor për politikat makro dhe, në fund të fundit, edhe disbalancat e buxhetit, prishin punë. Shpenzimet e rimbursimit të barnave në vitin 2016 kanë qenë 8,6 miliardë lekë, ndërsa në vitin 2017 kanë qenë 10,5. Këtë vit pritet të shkojnë 11 miliardë lekë. Në projektbuxhet keni vënë për herë të parë një kusht (10,5), që për mendimin tim nuk duhet ta vini këtë kusht edhe për faktin se 10,5 është më pak se fakti i këtij viti. I bie që në nëntor të krijoni probleme. Megjithatë, kjo është e njëra çështje.

Zëvendësministri tha se kanë bërë inspektime në fond dhe, se nuk besojnë shumë që ai rimbursim është real, por ka fiktivitet.

Ajo që më ka shqetësuar më shumë është fakti që, sipas anketës së buxheteve familjare në vitin 2017 janë rritur shumë edhe shpenzimet nga xhepi për barnat. Kështu, nga njëra anë konsumatori (në këtë rast pacienti), mund të jetë më pak i mbrojtur nga doktorët që japin receta, minimumi për të qenë më të sigurt dhe maksimumi, se edhe lëviz ndonjë gjë me recetat që japin.

Nga ana tjetër, nëse lekët shpenzohen për rimbursim dhe nuk përdoren me efektivitet, është gjynah.

Në tetor 2013, kur ishte TVSH-ja e barnave 10% dhe ne e kishim premtuar në programin tonë ta bënim zero, nuk e bëmë zero sepse nuk na la FMN-ja, e cila e quajti zeron një tarifë tjetër dhe na tha ta përjashtojmë. Unë atëherë, kam qenë ministër Shëndetësie dhe kam insistuar të vihej 0-1, sepse kuadrimi i saj e bën gjënë shumë më të përgjegjshme.

Unë e di që po t'ju propozoj sot ta bëjmë zero për barnat dhe për shërbimet shëndetësore, ju bëhet shumë kreditore dhe e keni barrë, por ndajini për një moment barnat nga shërbimet mjekësore, sepse te barnat s'keni ndonjë barrë të madhe kreditore. Vetëm te barnat, jo te shërbimet mjekësore, jo për spitalet e as për klinikat.

Ndërkohë, janë 2 masa që nuk po i bëni aktive, për track-trace-in e barnave. Ka 3 vjet që është kontrata në parlament. Po të ishte track-trace-i i barnave, nuk kishte nevojë as për TVSH, se e gjeje ku të doje.

Për sa kohë nuk po e bëni track-trace-in e barnave, për sa kohë recetën elektronike nuk po e shtrini edhe te privati, megjithëse sistemi është i bërë, për të mbrojtur edhe buxhetin edhe konsumatorin, unë do të propozoja TVSH-në e barnave 0%.

Nuk po ju them për shërbimet mjekësore, se e di që do të thoni se keni probleme kreditimi dhe do të thoni se Ilir Beqe e ka monopol industrinë private shëndetësore. E di që do ta thoni këtë, por kam dëgjuar aq shumë, sa e mbaj edhe këtë.

Për mua, rritja me 2 miliardë e rimbursimit pa asnjë pacient më shumë dhe pa asnjë kënaqësi më të madhe për shqiptarët, se aty ka nevojë edhe për më shumë, por të rritësh nga 8,5 miliardë në 10,5 miliardë në një vit, gjë që nuk ka ndodhur kurrë në 20 vjet dhe njerëzit të mos thonë faleminderit për ndonjë gjë, këtu ka një gjë që nuk shkon. Lekët po harxhohen, se është si puna e asaj që thamë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po shifra 10,5 është më pak se fakti dhe do t'ju shkojë 11 ky vit.

Nikolla Lera – Kjo skemë do të rikonceptohet nëpërmjet auditimit komplet.

Ilir Beqaj – Për mendimin tim TVSH-ja zero, ju ndihmon shumë më tepër dhe te barnat kemi shumë më pak kreditorë, ndërsa në shërbimin shëndetësor ka edhe aty, është tjetër gjë, por ti nuk je i detyruar t'i mbash të dyja bashkë, mund ti ndash barnat nga shërbimi, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po dikur ka qenë TVSH-ja 10%.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Mbaruat?

Ilir Beqaj – Po.

Eduard Shalsi – Urdhëroni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me mikrofon!

Nikolla Lera – Në fakt, situata e rimbursimeve është përmirësuar. Po ta krahasojmë me 5-8-10 vjet ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – A kemi një situatë të përmirësuar?

Nikolla Lera – Po, kemi një situatë të përmirësuar.

Pra, ne sot, ose në këto vite rimbursojmë rreth 15 miliardë në vit TVSH, ndërsa me përqindje rimbursojmë 5-6% të TVSH-së totale, që mbledhim nga tatimet dhe nga doganat.

Eduard Shalsi – Rimbursoni 5-6%?

Nikolla Lera – Po.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, po flas për stokun e rimbursimeve, sepse është real. Realisht, me shifra të sakta dhe të freskëta, ne kemi një stok të parimbursuar kërkesash që duhet t'i rimbursanim,

rreth 2,5 miliardë lekë. Nga se përbëhet? 10 miliardë lekë janë kërkesat e subjekteve të TAP-it, të AIEN-it, që është një hidrocentral që po e ndërton një kompani turke në Fan dhe të Bankers-it. Kryesisht, të dy të parëve. Pse janë këto? Janë, sepse ky hidrocentrali të gjitha situacionet, pagesat apo materialet e 4 vjetëve i paraqiti njëkohësisht, direkt pas 4 vjetëve dhe solli një kërkesë rimbursimi për 4,5 miliardë lekë para 10-11 muajsh, që është një barrë shumë e rëndë për buxhetin.

Ndërkohë, TAP-i pati investime intensive për rreth 12-15 muaj dhe ka paraqitur një kërkesë për rimbursim për rreth 13 miliardë lekë. Ne kemi mundur t'i japim deri tani rreth 4-5 miliardë lekë dhe nuk mundemi ta shlyejmë plotësisht.

Çfarë bëmë me këto 3 subjekte, pra për 12,5 miliardë lekë?

Me këto 3 subjekte ne kemi lidhur marrëveshje për të bërë pagesa me këste. Në shkurt të vitit 2020 ne mbarojmë me TAP-in që është i fundit, ndërsa me AIEN-in më përpara. Do të paguajmë rreth 550 milionë për të 3 subjektet (280 milionë për TAP-in, 150 milionë për AIEN-in dhe diferencën për Bankers-in), pra nuk e konsiderojmë si një borxh emergjent këtë 10-miliardësh, sepse jemi dakordësuar.

Nga se përbëhet 2,5? Kjo përbëhet nga kërkesat e eksportuesve, të grumbulluesve, të fasonëve...

Vërtet ne nuk e kemi dhënë në kohë, por jo të gjithën, sepse përfshin ato që duhet të japë brenda 30 apo 60 ditësh. Mund të mos ketë kaluar afati 60-ditor.

Pse nuk është problematik dhe pse fryhet më tepër se ç'duhet çështja e rimbursimeve? Ndodh kështu, sepse ne japim 1,3 miliardë-1,4 miliardë çdo muaj, që do të thotë se këtë stok ne për 2 muaj e bëjmë zero, nëse do ta japim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në fund të vitit, patjetër për shumën 2,5. Do të vijnë edhe 1 apo edhe dy të tjera, që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pse do të lehtësohet?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këto janë shifra zyrtare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, ka ankesa.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ua japim dot brenda 30-60 ditëve, por ua japim 1-2 muaj me vonesë.

Eduard Shalsi – Pra, ua jepni me vonesë? Kjo ishte pyetja.

Nikolla Lera – Po. Janë dy gjëra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ndodh që të mos ua japim fare. Ka vonesa, por jo që të mos t'i rimbursojmë.

Eduard Shalsi – Niko,

Dy gjëra kanë ardhur në vëmendjen tonë, si komision, në lidhje me TVSH-në.

Në radhë të parë, bizneset na kanë thënë që duhet të parashikojnë dhe mund të presin edhe dy javë, edhe 1-2-3-4 muaj, mjafton t'u thoni datën se kur, që ata të bëjnë llogaritë e tyre.

E dyta, ka biznese që nuk kanë 3-4 muaj vonesa, por na janë ankuar për 7-8-9-10 muaj. Nuk ka mundësi?

Nikolla Lera – Eksportuesit na bëjnë presion dhe ne jemi të detyruar t'ua japim.

Eduard Shalsi – Pyetja e tretë që kam është: më përpara mund të ngatërrohej radha dhe të kalohej i njëzeti apo i tetëdhjeti, i pari. Binte një zile telefoni dhe thuhej se të ndihmohej filani. A ka një sistem që atij që i ka lindur detyrimi...

Nikolla Lera – *First in, first out...*

Eduard Shalsi – *First in, first out?* Bravo! A ka një sistem të tillë?

Nikolla Lera – Nuk mund të them që është 100% efektiv, sepse gënjejmë.

Eduard Shalsi – Sa përqind? A është 70% apo 80%?

Nikolla Lera – Besoj se është 60%-80% efektiv. Ju e kuptoni që ka emergjenca të një kompanie, e cila është në mungesë totale mjetesh, sepse janë të gjithë eksportues.

Eduard Shalsi – Çështja është që ne nuk duam, që faktori subjektiv

Nikolla Lera – Ne kemi marrë masa.

Eduard Shalsi – Do të ishte shumë mirë të ndërtohej një sistem, i cili t'i thoshte në mënyrë që subjekti ta kalkulonte.

Mos varet kjo vonesë nga ndërhyrjet?

Nikolla Lera – Ju keni plotësisht të drejtë. Ne kemi marrë 2 masa. Njëra masë që e kemi propozuar në këtë paketë, është konsiderimi si furnizim i përjashtuar i furnizimit të nënkontraktorëve për kontraktorët kryesorë. Çfarë ndodh?

Shpesh kompanitë kryesore fasone, kur kanë pik pune, që nuk e përballojnë dot, ua japin nënkontraktorëve, që janë zakonisht kompani të vogla me 10-20-30 punëtorë, që qepin këpucë apo veshje e të tjera. Deri tani furnizimi i këtyre, pra shërbimi që u kryejnë këta nënkontraktorë kontraktorëve ose eksportuesve kryesorë, ka qenë me TVSH, që do të thotë: unë si nënkontraktor ua faturoja juve, si eksportues kryesorë dhe TVSH-në që unë jua faturoja juve, ju ia kërkonit shtetit sepse mallin e eksportoni, ndërkohë që unë duhet t'ia

paguaja buxhetit të shtetit. Kjo skemë ka bërë që kërkesa e eksportuesve të rritet shumë dhe ne, duke mos ua dhënë në kohë eksportuesve, ata e likuidojnë nënkontraktin me vonesë ose i thonë: nuk do të të likuioj 120 lekë, por do të të likuioj 100 lekë dhe 20 lekëshin, që më ke faturuar TVSH, do të ta jap kur shteti të më japë rimbursimin.

Çfarë bëmë ne?

Në këtë paketë e kemi dhënë të përjashtuar këtë shërbim, pra që nënkontraktori t'ia japë pa TVSH kontraktorit, në mënyrë që të lehtësohet kërkesa për rimbursim eksportuesit dhe të mos krijohet problemi *cash flow*.

Eduard Shalsi – Dakord.

Faleminderit, Niko!

Për kolegët: nesër kemi 2 mbledhje. E para, është në orën 09:30, një dëgjese me ministrin Gjoknuri dhe në orën 12:00 do të kemi dëgjese me ministrin Niko Peleshi.

Ditën e enjte nuk ka parlament dhe do të bëjmë dëgjese me FSHZH-në dhe në orën 11:00 deri në orën 13:00, do të bëjmë dëgjese me 4-5 biznese çdo gjysmë ore.

Do të njoftoni Elonën për grupet e interesit, që doni të dëgjohen dhe dëgjese me to, do ta lëmë për ditën e enjte.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në fushat që gjykoni. Për shembull, për rentën minerare kanë kërkuar një dëgjese. Cilët kishin kërkuar tjetër Ilir? Prodhuesit e birrës?

Nuk e di. Shihni kërkesat!

Planifikoni që të enjten ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, të enjten.

MBYLLET MBLEDHJA